Vendim nr. 332, datë 20.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 20.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (D) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DEMIR DOLLANI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 3612, datë 08.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2314, datë 10.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2026-98, datë 21.01.2026 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja "e", 50, pika 4, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me urdhrin nr. 4122, datë 11.12.1981 të ministrit të Mbrojtjes, kërkuesi ka marrë titullin "oficer aktiv" dhe ka shërbyer në Forcat e Armatosura. Po ashtu, rezulton se me urdhrin nr. 1000, datë 04.08.2006 të ministrit të Mbrojtjes kërkuesi është nxjerrë në rezervë.

2. Me vendimin nr. 4917, datë 19.02.2009, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Tiranë (palë e paditur) i ka caktuar kërkuesit pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi si ushtarak, me periudhë sigurimi 24 vjet e 9 muaj, në masën 19.030 lekë, me të drejtë pagese nga data 01.09.2008 deri në datën 05.04.2022. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 10142/2009*), DRSSH-ja, Tiranë ka rishqyrtuar pensionin e parakohshëm të paditësit, duke e caktuar atë në masën 17.712 lekë.

3. Duke mos qenë dakord me masën e pensionit të rillogaritur, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë DRSSH-së, Tiranë, e cila, me shkresën nr. 6608/1 prot., datë 21.11.2011, e ka sqaruar se rillogaritja është bërë në zbatim të nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009. Në vijim, kërkuesi në datën 25.07.2011 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e DRSSH-së, Tiranë të rillogarisë pensionin dhe të paguajë diferencat për pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi që nga data 01.09.2008 […].

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3612, datë 08.04.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; detyrimin e DRSSH-së, Tiranë t'i rillogarisë kërkuesit pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe t'i paguajë diferencat për pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi nga data 01.09.2008 deri në datën 30.06.2009; rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër. Sipas gjykatës së shkallës së parë, DRSSH-ja nuk ka zbatuar drejt dispozitat ligjore në përcaktimin e masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të paditësit, pasi ka marrë për bazë pagën e tij në momentin e daljes në rezervë, dhe jo pagën që ai përfitonte në momentin që i ka lindur e drejta për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, si dhe ka zbatuar kufizimin e pensionit në masën maksimale të pensionit të pleqërisë, ndonëse ky kufizim ishte shfuqizuar. Për rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se kërkuesi kishte të drejtë të përfitonte rillogaritjen e pensionit dhe pagimin e diferencave përkatëse. Ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë kanë bërë ankim kërkuesi, i cili ka kërkuar ndryshimin e tij dhe pranimin e plotë të kërkesëpadisë, si dhe DRSSH-ja, Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1584, datë 22.04.2014, ka vendosur moskompetencën e saj për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2525, datë 25.06.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3612, datë 08.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesi, i cili ka kërkuar ndryshimin pjesërisht të tij dhe pranimin e plotë të kërkesëpadisë, si dhe DRSSH-ja, Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-944 (692), datë 07.06.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2525, datë 25.06.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë.

8. Gjykata Administrative e Apelit, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 2314, datë 10.09.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 3612, datë 08.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj e prova, pasi është marrë në zbatim dhe interpretim të gabuar të provave dhe dispozitave të zbatueshme në rastin konkret. Sipas asaj gjykate, gjatë kohës së gjykimit të kësaj çështjeje, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë marrë vendimin unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 dhe bazuar në këtë vendim, gjykata e apelit ka vlerësuar se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi i paditësit (kërkuesit) është llogaritur drejt nga pala e paditur, në zbatim të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (*ligji nr. 8087/1996*), të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, sipas të cilit masa e pensionit nuk mund të tejkalojë pensionin maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Po ashtu, gjykata e apelit ka arsyetuar se për periudhën deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009 nuk zbatohej skema e përllogaritjes e parashikuar nga ligji nr. 9418, datë 20.05.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura" (*ligji nr. 9418/2005*), ndërsa pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, pensioni i parakohshëm i nënshtrohej rillogaritjes sipas këtij ligji, edhe kur kjo sillte uljen e masës së pensionit të caktuar më parë. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2026-98, datë 21.01.2026, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas Kolegjit Administrativ, rekursi nuk përmban asnjë shkak që lidhet me zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural nga gjykatat më të ulëta, me rëndësi themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose

zhvillimin e praktikës gjyqësore; vlerësimin se vendimi është në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; ekzistencën e shkeljeve të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit, referuar nenit 54 të ligjit nr. 49/2012 ose nenit 467 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Sipas Kolegjit Administrativ, në rekursin e paraqitur nga kërkuesi nuk është argumentuar asnjë shkak i vlefshëm ligjor, në kuptim të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, që mund të cenojë ligjshmërinë e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe nuk ka ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet *ex officio* nga Gjykata e Lartë.

10. Në datën 20.05.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 22.06.2026.

11. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

12.1. *Parimi i shtetit të së drejtës,* pasi vendimet gjyqësore i kanë cenuar të drejtën e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në përputhje me ligjin nr. 9210, datë 03.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 9210/2004*). Gjyqtarët kanë qenë arbitrarë në zbatimin e Kushtetutës dhe ligjit nr. 9210/2004. Ligjet nr. 8087/1996, nr. 9418/2005 dhe nr. 10142/2009, të cilat janë miratuar sipas nenit 78, pika 1, të Kushtetutës me shumicën e votave, në prani të më shumë së gjysmës së anëtarëve të Kuvendit, nuk përcaktojnë pozitën juridike të ushtarakëve pas ndërprerjes së karrierës dhe mbetjes pa punë dhe pa mjete të tjera jetese. Këto janë ligje që u garantojnë ushtarakëve të Forcave të Armatosura dhe anëtarëve të familjes së tyre përfitime suplementare mbi ato të përcaktuara nga ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar (*ligji nr. 7703/1993*). Si të tilla, ato nuk kishin kompetencën e ndryshimit të pozitës juridike të përcaktuar nga neni 35, pika 1, i ligjit nr. 9210.2004. Vendimet gjyqësore janë në kundërshtim me ligjin nr. 7703/1993. Edhe interpretimi i ligjit

nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 3, datë 24.11.2016, është absurd.

12.2. *Parimi i hierarkisë së akteve dhe rendit juridik,* pasi gjykatat që kanë gjykuar çështjen e kërkuesit dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 3, datë 24.11.2016 kanë kufizuar zbatimin e nenit 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004. Kufizimet nga neni 14, pika 3, i ligjit nr. 9418/2005 dhe neni 14, pika 2, i ligjit nr. 10142/2009, nuk respektojnë procedurën e parashikuar nga neni 81, pika 2, shkronja "e", i Kushtetutës, pasi nga pikëpamja e burimit të së drejtës nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet ose ligjet organike. Si të tilla, këto dispozita nuk mund të ishin pjesë e këtyre ligjeve, për sa kohë masa e pensionit ishte përcaktuar nga ligji nr. 9210/2004. Gjykatat në zbatimin e ligjit nuk kanë respektuar parimin e hierarkisë së akteve.

12.3. *E drejta për pension,* pasi gjykatat që kanë gjykuar çështjen e kërkuesit dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga sigurim shoqëror të detyrueshëm e kanë vlerësuar si sigurim shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura dhe për këtë shkak kanë përligjur kufizimin e masës së pensionit për vjetërsi shërbimi nga data 01.09.2008. Në pavlefshmëri absolute me ligjin, gjykatat kanë kufizuar masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Vendimet e kundërshtuara, për shkak të vlerësimit dhe trajtimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi si sigurim shoqëror suplementar, përligjin zvogëlimin e masës së këtij pensioni në raport me të drejtën e fituar, në përputhje me nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004.

12.4. *Parimi i fuqisë prapavepruese të ligjit,* pasi gjykatat i kanë dhënë fuqi prapavepruese nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 dhe rillogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të përfituar dhe caktuar me ligjin nr. 8087/1996. Nuk ishte kushti i ndërhyrjes së ligjit për të rregulluar situata të paligjshme të krijuara më parë dhe as në kushtet e një ligji që interpretonte anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm me pasoja të rënda, por ishte rasti i moszbatimit të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996. Jemi në rastin e paligjshmërisë së veprimeve dhe vendimeve të sigurimeve shoqërore në caktimin e pensionit të pleqësisë për vjetërsi shërbimi nga moszbatimi i nenit 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004. Neni 29 i ligjit nr. 10142/2009 kishte fuqi prapavepruese vetëm në rastin e rritjes së masës së pensionit dhe jo në uljen e asaj mase.

12.5. *E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja e kërkuesit nuk është gjykuar sipas afateve të përcaktuara në nenet 48, pika 2, 69, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 dhe 399/2 të KPC-së. Shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Administrativ është bërë pas 7 vjetësh nga data e regjistrimit të çështjes.

12.6. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë,* pasi ky i fundit nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar kërkimeve të kërkuesit të ngritura në rekurs, sipas nenit 58 të ligjit nr. 49/2012.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

13. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë ndërgjyqëse (palë paditëse) në procesin gjyqësor dhe provon interesin në çështjen e parashtruar.

15. Për sa i përket kriterit për *shterimin e mjeteve juridike efektive,* në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Një tjetër kriter për të paraqitur ankim kushtetues individual është edhe legjitimimi *ratione temporis*, i parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të

Gjykatës, i cili përcakton afatin ligjor 4-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë nga konstatimi i cenimit.

17. Lidhur me vendimet objekt të këtij ankimi kushtetues, Kolegji konstaton se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 21.01.2026, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 20.05.2026, pra brenda afatit 4-mujor.

18. Po ashtu, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Në lidhje me këtë pretendim, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual kërkuesi ka paraqitur edhe vendimin nr. 00-2025-4703, datë 23.12.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së kërkuesit dhe urdhërimin e shqyrtimit të saj sa më parë. Në këtë vendim, Kolegji Administrativ ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës së kërkuesit, me arsyetimin se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit dhe se për çështjen e kërkuesit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ishte planifikuar data e shqyrtimit të saj, që ishte data 21.01.2026 (data e vendimit të Kolegjit Administrativ objekt i këtij ankimi kushtetues).

19. Në këtë kuptim, për sa i takon pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, *së pari,* Kolegji vëren se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka gjykuar kërkesën e kërkuesit për cenimin e afatit të arsyeshëm nuk është objekt i ankimit kushtetues individual të kërkuesit dhe kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë pretendim për të. *Së dyti*, referuar datës së atij vendimi, 23.12.2025 dhe datës së paraqitjes së ankimit kushtues individual, 20.05.2026, evidentohet se ky pretendim është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës. Për këto arsye, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim

20. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës, parimit të hierarkisë së akteve, parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit dhe së drejtës për pension* (*shih paragrafët 12.1.-12.4. të vendimit*).

21. Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në

zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Referuar argumenteve të sjella nga kërkuesi në mbështetje të pretendimeve të tij, sa më sipër, Kolegji vëren se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështjen e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mbi bazën e të cilit gjykatat kanë arritur në përfundimet e tyre për pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë (gjykata e shkallës së parë) dhe më tej për rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit (gjykata e apelit), të cilat, si të tilla, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument konkret kushtetues për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor nga ato gjykata. Në kushtet kur kërkuesi megjithëse ka evidentuar të drejtat dhe parimet kushtetuese që pretendon se i janë cenuar si pasojë e mënyrës se si kanë vepruar gjykatat në zgjidhjen e çështjes konkrete, por nuk ka arritur të paraqesë argumente kushtetuese në mbështetje të këtyre pretendimeve, Kolegji vlerëson se ato mbeten në nivelin e ligjshmërisë, ndaj nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim.

23. Për më tepër, Kolegji konstaton se, *së pari*, juridiksioni gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi nëpërmjet kërkesëpadisë së tij drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, ku këto gjykata, pasi i kanë marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura nga kërkuesi në aktet e ankimit, i kanë dhënë përgjigje atij me vendime të arsyetuara, të cilat nuk rezultojnë të jenë jologjike ose kontradiktore në vlerësimin e tyre. Ato vendime kanë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe nuk kanë tejkaluar funksionet kushtetuese, si dhe nuk kanë interpretuar ligjin në mënyrë arbitrare ose të paarsyeshme në kuptimin kushtetues. *Së dyti*, çështja e kërkuesit paraqet dallim nga rastet e tjera të shqyrtuara më parë nga Gjykata, lidhur me rillogaritjet e pensionit nga DRSSH-ja, pasi pensioni i kërkuesit është rillogaritur në vitin 2009, ndërsa çështjet e mëparshme të shqyrtuara nga Gjykata kanë pasur si objekt kundërshtimin e përllogaritjes së pensioneve të kryera përpara vitit 2009, pra përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009.

24. Për rrjedhojë, bazuar në arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për këto pretendime të tij.

25. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi, sipas tij, ky i fundit nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar kërkimeve të ngritura në rekurs, sipas nenit 58 të ligjit nr. 49/2012.

26. Për sa i takon arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i arsyetimit është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Detyrimi për arsyetim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po në këtë drejtim, Gjykata ka pranuar se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë, ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është vënë në lëvizje nëpërmjet kërkesëpadisë së paraqitur prej tij, ku gjykata e shkallës së parë e ka pranuar pjesërisht atë, ndërsa gjykata e apelit, duke vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në zbatim dhe interpretim të gabuar të provave dhe dispozitave të aplikueshme ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka parashtruar në pjesën hyrëse të vendimit shkaqet e tij (rekursit), ka vlerësuar se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, të cilat mund të cenonin ligjshmërinë e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke vendosur në përfundim të gjykimit mospranimin e rekursit.

28. Për sa më lart, Kolegji konstaton se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta dhe ka listuar shkaqet e ngritura në rekurs, si dhe vlerësimin se ato shkaqe nuk parashikohen nga ligji, duke përmbushur standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit. Në këtë kuptim, nuk rezulton të jetë cenuar e drejta e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor. Edhe pse Gjykata e Lartë ka

vendosur mospranimin e rekursit me arsyetim të kufizuar, ky arsyetim është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për vendimmarrjet e marra në dhomën e këshillimit, pasi u jep përgjigje pretendimeve që hynin në juridiksionin e saj dhe bën të mundur kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese. Arsyetimi i kufizuar i vendimit të mospranimit, i lexuar së bashku me paraqitjen e shkaqeve të rekursit dhe arsyetimin e gjykatave të faktit, bën të identifikueshme arsyet e mospranimit. Në këto rrethana, fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit nuk përbën, në vetvete, një element që vë në dyshim drejtësinë e procedurës së ndjekur ose pajtueshmërinë e saj me garancitë kushtetuese të procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.